



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 1116 AKTI

VENDIM

“PËR VENIEN E SEKUESTROS PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTAR: RIDVAN HADO

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Ornela Kaja, datë 04.07.2013, shqyrtoi kërkesën që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë përfaqësuar nga prokuror Armand Gurakuqi.

OBJEKTI: Per venien e sekuestros preventive.

BAZA LIGJORE:Neni 36 i Kodit Penal dhe neni 274, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata, pasi dëgjoi prokurorin që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi materialin procedues,

VËREN

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën e datës 02.07.2013, kërkon të vendoset sekuestro preventive për pasuritë e shtetasit I.A:

1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.19, fq.75, truall dhe dyqan me sip.100 m2, në bashkëpronësi me shtetasen E.A, me çmim 265,000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.2, fq.217, arë me sip.2134 m2, me vlerë 100.000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....)vol.2, fq.218, arë me sip.2133 m2, me vlerë 100.000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....)vol.2, fq. 219, arë me sip.2133 m2, me vlerë 100.000 lekë.

1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.2, fq.107, arë me sip.1640 m2, me vlerë 888,880 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.2, fq.232, arë me sip.5000 m2, me vlerë 100.000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.24, fq. 245, truall me sip.40 m2, me vlerë 400.000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.2, fq.233, arë me sip.10360 m2, me vlerë 5,615,120 lekë.
1. Pasuria (.....)ZK. (.....)vol.1, fq.140, arë me sip.9000 m2, me vlerë 100.000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....)vol.1, fq.162, arë me sip.1430 m2, me vlerë 775,060 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.30, fq.144, truall me sip.52,48 m2, me vlerë 20,992 USD.

Nga aktet shoqëruese të kërkesës si dhe parashtrimet e prokurorit të çështjes, rezulton sa më poshtë:

Se në date 09.01.2013 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga shtetasit M.P, B.P dhe H.P, ka regjistruar procedimin penal nr.41, për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga nenet 186 dhe 143 të K.P.

Në date 09.01.2013 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga shtetasit M.P, B.P dhe H.P, ka regjistruar procedimin penal nr.42, për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga nenet 186 dhe 143 të K.P.

Procedimet e mësipërme penale janë bashkuar në një të vetëm me numër 41.

Nga ana e organit të akuzës pretendohet se shtetasi I.A në datat 06.04.2011, 28.07.2011, 02.05.2012 dhe 04.08.2012, në mënyrë të përsëritur ka falsifikuar një numër të konsiderueshëm aktesh noteriale, të hartuara para noterëve Mimoza Sadushaj dhe Edlira Hyseni.

Konkretisht organi akuzës pretendon se janë falsifikuar aktet e mëposhtëme :

1.Prokura e posaçme nr.3163/1611 dt.04.08.2012, e hartuar pranë noterës Mimoza Sadushi, ku është falsifikuar nënshkrimi i të ndjerit F.P, akt me të cilin është zgjedhur si përfaqësues shtetasi I.A, bashkëshorti i vajzës së shtetasës M.P, e cila është motra e të ndjerit F.

2.Deklarata noteriale nr.3164/1612 dt.04.08.2012, e hartuar pranë noterës Mimoza Sadushi, ku është falsifikuar nënshkrimi i të ndjerit F.P, akt me të cilin shtetasi F. pranon marrjen e një huaje prej 210.000 USD nga shtetasi I.A.

3.Prokura e posaçme nr.2915/663 dt.02.05.2012, e hartuar pranë noterës Edlira Hyseni, ku janë falsifikuar nënshkrimet e të përfaqësuarve B.P, H.P, M.P dhe F.P, akt me të cilin është zgjedhur si përfaqësues shtetasi I.A.

4.Kontratat e dhurimit nr.3157/1606, 3158/1606, 3159/1607, 3160/1608 dhe 3161/1669 dt.04.08.2012, në të cilat është falsifikuar përmbajtja lidhur me personat e përfaqësuar dhe vullneti i tyre për të tjetërsuar pasuritë në pronësi të tyre, në favor të djalit të shtetasit I.A, të quajtur H.A.

5.Kontrata e kalimit të të drejtave 1625/853 dt.06.04.2011, ku është falsifikuar përmbajtja dhe nënshkrimi i shtetasve B.P, H.P, M.P dhe F.P, me palë këto persona dhe shtetasin I.A, akt i hartuar pranë noteres Mimoza Sadushi.

6.Kontrata e kalimit të të drejtave 2924/1490 dt.28.07.2011, në të cilat është falsifikuar përmbajtja lidhur me personat e përfaqësuar dhe vullneti i tyre për kalimin e të drejtave të tyre të pronësisë në emër të shtetasit H.A, akt i hartuar pranë noteres Mimoza Sadushi.

7.Prokura e posaçme nr.3162/1610 dt.04.08.2012, e hartuar pranë noteres Mimoza Sadushi, ku është falsifikuar nënshkrimi i të përfaqësuarës M.P, akt me të cilin është zgjedhur si përfaqësues shtetasi I.A, për te kryer veprime pranë Raiffeisen bank, në llogarinë e shtetases M.

Gjithashtu shtetasi I.A ka depozituar në ZVRPP-në Tiranë kontratat e falsifikuara të dhurimit nr.3157/1606, 3158/1606, 3159/1607, 3160/1608 dhe 3161/1669 dt.04.08.2012. Me këtë veprim I.A, në cilësinë e përfaqësuesit, ka tjetërsuar pesë pasuritë e shtetasve B.P, H.P, M.P dhe F.P, nr. 4/167, nr. 6/215, nr.6/270, nr. 6/265 dhe nr. 6/271, në favor të djalit të tij H.A.

Sa më sipër organi i akuzës pretendon se me prodhimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara të lartpërmendura, shtetasi I.A ka konsumuar veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” më shumë se një herë, me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 186/2 i K.P. Gjithashtu prokura dhe deklarata noteriale në emër të shtetasit F.P, janë përdorur nga shtetasi I.A në bankën Raiffesien, ku ky person ka tentuar të tërheqë nga llogaria bankare e të ndjerit shumë 210.000 dollarë amerikanë. Në këtë mënyrë, duke përdorur gënjeshtëri pranë bankës, shtetasi I. ka tentuar të vjedhë vlerën e mësipërme. Me këto veprime pretendon akuza shtetasi I.A ka konsumuar edhe veprën penale “Mashtrimi”, me pasojë të rëndë, i mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 143/2-22 i K.P.

Po kështu shtetasi I.A pretendon akuza ka mashtruar edhe shtetasin H.P, duke i marrë atij shumë 220.000 euro të depozituar në bankën Raiffesien. Për këtë veprim shtetasi I. ka bindur H.P për të nënshkruar një prokurë me nr.3676/1591, dt.12.09.2012, me të cilën i jepte të drejtë atij (I.it) që të tërhiqte shumë pranë bankës në fjalë. Duke besuar tek shtetasi I.A, H.P ka nënshkruar prokurën e mësipërme në banesën e tij. Për të mundësuar plotësimin e prokurës me të dhënat bankare të shtetasit H.P, I.A është paraqitur pranë bankës Raiffeisen. Në këtë institucion ka kërkuar dhe është pajisur me të dhënat mbi numrin e llogarisë së të dëmtuarit H., në mungesë të autorizimit të lëshuar nga ky person dhe në kushtet kur ato (të dhënat) përbëjnë sekret bankar. Pas hartimit të prokurës, I.A ka bërë tërheqjen e shumë pranë bankës Raiffesien, të cilën nuk ia ka dorëzuar shtetasit H.P, por e ka përvetësuar në favor të tij. Me këto veprime shtetasi I.A ka konsumuar veprën penale “Mashtrimi”, me pasojë të rëndë, parashikuar nga neni 143/2 i K.P.

Nga akt ekspertimit grafik e teknik nr.5985, dt.06.06.2013 rezulton se:

- A) Në prokurën e posaçme nr. 3163 rep. dhe 1611 kol, date 04.08.2012, e hartuar pranë noteres Mimoza Sadushi, akt me të cilin është zgjedhur si përfaqësues shtetasi I.A, është falsifikuar nënshkrimi (emër, mbiemër, firmë) i të ndjerit F.P.
- B) Në Deklaratën Noteriale nr. 3164 rep. dhe 1612 kol, date 04.08.2012, e hartuar pranë noteres Mimoza Sadushi, akt me të cilin shtetasi F. pranon marrjen e një huaje prej 210.000 USD nga shtetasi I.A, është falsifikuar nënshkrimi (emër, mbiemër, firmë) i të ndjerit F.P.
- C) Në prokurën e përgjithshme nr.2915/663 dt.02.05.2012, e hartuar pranë noteres Edlira Hyseni, akt me të cilin është zgjedhur si përfaqësues shtetasi I.A, janë falsifikuar nënshkrimet e të përfaqësuarve B.P, H.P, M.P dhe F.P.,.
- I. Në Kontratat e dhurimit nr.3157/1606, 3158/1606, 3159/1607, 3160/1608 dhe 3161/1669 dt.04.08.2012, në cilësinë e përfaqësuesit të shtetasve B.P, H.P, M.P dhe F.P ka nënshkruar nga shtetasi I.A. Nënshkrimet "Emër, mbiemër, firme", ne faqen e fundit poshtë rekuizitës "PALA PRANUESE" dhe firmat ne tre faqet e para te kontratës, janë shkruar nga H.A. *Përfaqësuesi I.A ka vepruar duke përdorur prokurën e përgjithshme të falsifikuar nr.2915/663 dt.02.05.2012, e hartuar pranë noteres Edlira Hyseni.*
- II. Në Kontratën Kalim te Drejtash Kundrejt Shpërblimit nr. 1625 rep. dhe nr. 853 kol, date 06.04.2011, është falsifikuar nënshkrimi i shtetasve B.P, H.P, M.P dhe F.P, akt i hartuar pranë noteres Mimoza Sadushi, me palë këto persona dhe shtetasin I.A, është falsifikuar nënshkrimi i shtetasve B.P, H.P, M.P dhe F.P. Shkrimi dhe nënshkrimi ne rekuizitën "Pala e Dyte, Blerësi", nen emrin e shtetasit I.A dhe nënshkrimi ne fund te çdo flete te kësaj kontrate, janë shkruar nga I.A.
- I. Ne Kontratën Kalim te Drejtash Kundrejt Shpërblimit nr. 2924 rep. dhe nr. 1490 kol, date 28.07.2012, nga pala e pare: B.P, H.P, M.P, F.P dhe Pala e Dyte H.A, shkrimi dhe nënshkrimi ne rekuizitën "Te gjithë personat e mësipërm janë përfaqësuar me prokure nga z.I.A" si dhe nënshkrimi ne fund te çdo flete te kësaj kontrate janë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi I.A. Shkrimi dhe nënshkrimi ne rekuizitën "Pala e Dyte, blerësi, H.A", si dhe nënshkrimi ne fund te çdo flete te kësaj kontrate janë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi H.A. *Përfaqësuesi I.A ka vepruar duke përdorur prokurën e përgjithshme të falsifikuar nr.2915/663 dt.02.05.2012, e hartuar pranë noteres Edlira Hyseni.*
- I. Në prokurën e posaçme nr.3162/1610 dt.04.08.2012, e hartuar pranë noteres Mimoza Sadushi, me të cilin është zgjedhur si përfaqësues shtetasi I.A, për te kryer veprime pranë Raiffeisen bank, në llogarinë e shtetasës M., është falsifikuar nënshkrimi i të përfaqësuarës M.P.
- I. Gjithashtu shtetasi I.A ka depozituar në ZVRPP-në Tiranë kontratat e falsifikuara të dhurimit nr.3157/1606, 3158/1606, 3159/1607, 3160/1608 dhe 3161/1669 dt.04.08.2012. Me këtë veprim I.A, në cilësinë e përfaqësuesit, ka tjetërsuar pesë pasuritë e shtetasve B.P, H.P, M.P dhe F.P, nr. 4/167, nr. 6/215, nr.6/270, nr. 6/265 dhe nr. 6/271, në favor të djalit të tij H.A.

Në këto kushte organi i akuzës kërkoi vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë që shtetasi I.A ka pakësuar nga bashkëpronarët P. dhe i ka kaluar në favor të djalit të tij H.A, konkretisht:

1.Nr. (.....) Volumi 27, faqe 11, Zona Kadastrale (.....), numër hipotekor 510, date 07.09.2012, Tiranë, në pronësi të shtetasit H.A.

2.Nr. (.....), Volumi 17, faqe 141, Zona Kadastrale (.....)numër hipotekor 511, date 07.09.2012, Tiranë, në pronësi të shtetasit H.A.

3.Nr. (.....)Volumi 27, faqe 19, Zona Kadastrale (.....), numër hipotekor 509, date 07.09.2012, Tiranë, në pronësi të shtetasit H.A.

4. Nr. (.....), Volumi 17, faqe 140, Zona Kadastrale (.....)numër hipotekor 512, date 07.09.2012, Tiranë, në pronësi të shtetasit H.A.

6. Nr. (.....), Volum 16, faqe 217, Zona Kadastrale (.....), numër hipotekor 510, date 07.09.2012, Tiranë, në pronësi të shtetasit H.A.

Disponimi i lirë i pasurive të mësipërme, rëndon dhe zgjat pasojat e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” më shumë se një herë, me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 186/2 i K.P, të kryer nga shtetasi I.A. Ky vlerësim bazohet në veprimet e kryera nga shtetasi I., i cili aktualisht ka kryer tjetërsimin e pasurive në favor të djalit të tij H.A. Qëndrimi i mbajtur nga shtetasi I.A pasqyron qëllimin e tij për tjetërsimin e pronave. Njëkohësisht pasuritë e radhitura më lart, bëjnë pjesë në produktet e veprës penale që lejohen të konfiskohen sipas nenit 36 të K.P, si dhe të vendoset sekuestroja preventive edhe mbi pasuri të tjera, për të cilat ZVRPP-Tiranë, me shkresën 4654/1, dt.01.03.2013, konfirmon se janë në pronësi të shtetasit I.A, konkretisht:

1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.19, fq.75, truall dhe dyqan me sip.100 m2, në bashkëpronësi me shtetasen E.A, me çmim 265,000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK(.....)vol.2, fq.217, arë me sip.2134 m2, me vlerë 100.000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....)vol.2, fq.218, arë me sip.2133 m2, me vlerë 100.000 lekë.
1. Pasuria (.....)ZK. (.....), vol.2, fq. 219, arë me sip.2133 m2, me vlerë 100.000 lekë.
1. Pasuria(.....)ZK. (.....)vol.2, fq.107, arë me sip.1640 m2, me vlerë 888,880 lekë.
1. Pasuria (.....)ZK. (.....), vol.2, fq.232, arë me sip.5000 m2, me vlerë 100.000 lekë.
1. Pasuria (.....)ZK. (.....), vol.24, fq. 245, truall me sip.40 m2, me vlerë 400.000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.2, fq.233, arë me sip.10360 m2, me vlerë 5,615,120 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.1, fq.140, arë me sip.9000 m2, me vlerë 100.000 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.1, fq.162, arë me sip.1430 m2, me vlerë 775,060 lekë.
1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.30, fq.144, truall me sip.52,48 m2, me vlerë 20,992 USD.

Në analizë të akteve shkresore, gjykata, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, arrin në përfundimin se plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në nenet 274/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 pika 1, germa ‘ç’ të Kodit Penal, për vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e sipërcituara.

Neni 274/2 të K.Pr.Penale parashikon se sekuestroja preventive mund të vendoset për çdo pasuri që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të K.P. Pasuritë e mësipërme në

pronësi të shtetasit I.A, lejohet të konfiskohen në bazë të nenit 36 të K.P. Në pikën “ç” të këtij neni parashikohet konfiskimi i çdo pasurie vlere e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale. Produkti i veprës penale “Mashtrimi” më pasojë të rëndë të konsumuar nga I.A në dëm të shtetasit H.P, është në vlerën 220.000 euro.

Nga përgjigjet e bankave shqiptare të nivelit të dytë rezulton se në emër të shtetasit I.A nuk ka para të depozituara. Në këto kushte shuma 220.000 euro është marrë e më pas fshehur nga shtetasi I.A. Për pasojë pasuritë e mësipërme janë objekt konfiskimi sipas nenit 36 të K.P, pasi vlerat e tyre i korrespondojnë produkteve të veprës penale të “Mashtrimit”, në dëm të shtetasit H.P e si rezultat i këtij fakti ndaj tyre mund të vendoset sekuestroja preventive.

PËR KËTO ARSYE

Konform nenit 274/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendosjen e sekuestros preventive për pasuritë:
 1. Nr. (.....), Volumi 27, faqe 11, Zona Kadastrale 8350, numër hipotekor 510, date 07.09.2012.
 1. Nr. (.....), Volumi 17, faqe 141, Zona Kadastrale 8350, numër hipotekor 511, date 07.09.2012.
 1. Nr. (.....) Volumi 27, faqe 19, Zona Kadastrale 8350, numër hipotekor 509, date 07.09.2012.
 1. Nr. (.....), Volumi 17, faqe 140, Zona Kadastrale 8350, numër hipotekor 512, date 07.09.2012.
 1. Nr. (.....), Volum 16, faqe 217, Zona Kadastrale 8380, numër hipotekor 510, date 07.09.2012.
 1. Pasuria (.....), ZK.8350, vol.19, fq.75, truall dhe dyqan me sip.100 m2, në bashkëpronësi me shtetasen E.A, me çmim 265,000 lekë.
 1. Pasuria (.....), ZK. (.....)vol.2, fq.217, arë me sip.2134 m2, me vlerë 100.000 lekë.
 1. Pasuria (.....)ZK. (.....)vol.2, fq.218, arë me sip.2133 m2, me vlerë 100.000 lekë.
 1. Pasuria (.....), ZK. (.....)vol.2, fq. 219, arë me sip.2133 m2, me vlerë 100.000 lekë.
 1. Pasuria (.....)ZK. (.....), vol.2, fq.107, arë me sip.1640 m2, me vlerë 888,880 lekë.
 1. Pasuria (.....)ZK. (.....)vol.2, fq.232, arë me sip.5000 m2, me vlerë 100.000 lekë.
 1. Pasuria (.....), ZK. (.....)vol.24, fq. 245, truall me sip.40 m2, me vlerë 400.000 lekë.
 1. Pasuria (.....), ZK. (.....)vol.2, fq.233, arë me sip.10360 m2, me vlerë 5,615,120 lekë.
 1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.1, fq.140, arë me sip.9000 m2, me vlerë 100.000 lekë.
 1. Pasuria (.....), ZK. (.....), vol.1, fq.162, arë me sip.1430 m2, me vlerë 775,060 lekë.

1. Pasuria (.....), ZK. (.....)vol.30, fq.144, truall me sip.52,48 m2, me vlerë 20,992 USD.

Ngarkohen Oficerët e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Kundër Krimet Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

3. Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

– U shpall në Tiranë, sot më datë 04.07.2013.

SEKRETARE

GJYQTAR

ORNELA KAJA

RIDVAN HADO